



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1051 / Prot.
5

Tiranë, më 01/10/2013

REKOMANDIM

Nr 24 datë 01/10 2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "A.M.B.E" sh.p.k Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhërit nr.168 datë 04/09/2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "A.M.B.E" sh.p.k Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri dhe kontrolluesi u njoftua paraprakisht për ushtrimin e këtij kontrolli.

Kontrollit administrativ kishte si objekt:

- Ligjshmëria e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale, nëpërmjet përdorimit të sistemit "te video survejimit" (CCTV) sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vlerëson se:

Kontrolluesi "A.M.B.E" sh.p.k ka instaluar dhe përdor për mbikëqyrje dhe regjistrim sistemin e "video survejimit" (CCTV) në ambientet e "twin towers" (dy kullat), të cilët janë nën administrimin e tij lidhur me mirëmbajtjen dhe sigurinë e ambienteve. Përdorimi i sistemit "video survejimit" (CCTV), është i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave legjitime të kontrolluesit, i cili duhet ta përdorë atë duke mos ndërhyre në privatësinë e subjekteve të cilëve u përpunohet e dhëna personale (imazh) nëpërmjet përdorimit të këtij sistemi.

1. Kontrolluesi "A.M.B.E" sh.p.k nuk ka realizuar detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Plotësimi i detyrimit për njoftim është shumë i rëndësishëm pasi deklarohen të dhënat personale që mbledh dhe përpunon kontrolluesi si dhe qëllimi i përpunimit të të dhënave personale. Përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë një proces i bazuar në ligj dhe i drejtë, duke garantuar mbrojtjen maksimale të subjekteve të këtyre të dhënave. Në njoftim duhet të pasqyrohet qartë lidhja e qëllimit ose qëllimeve me kategorinë e të dhënave personale që përpunohen ose me kategorinë e të dhënave sensitive. Në njoftim duhet të përcaktohen saktësisht se cilët janë subjektet e të dhënave personale dhe çfarë të dhënash ju përpunohen atyre.

Kërkesa për plotësimin e detyrimit për njoftim pranë Autoritetit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda datës 30.09.2013, është e bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, e cila ju është detyre nga grupi i kontrollit administrativ, duhet të plotësohet brenda afatit të përcaktuar.

2. Kontrolluesi "A.M.B.E" sh.p.k nuk ka hartuar rregullore për qëllimin, mënyrat e mbledhjes, ruajtjes dhe përpunimit, të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të "*video survejimit*" (CCTV) në ambientet e tij duke shkelur:

- Nenin 27/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar... "*Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të pa autorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi*".
- Udhëzimin nr.3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" i ndryshuar.

Komisionieri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi. Përmirësimi dhe plotësimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Është e rëndësishme që të dhënat personale të mbahen të sigurta dhe që të mos keqpërdoren apo korruptohen në ndonjë mënyrë. Siguria lidhet me marrjen e masave për ruajtjen fizike të aparaturave, me organizimin e punës në një mënyrë të tillë që risku të minimizohet, duke e siguruar që personeli të mund ti shoh të dhënat vetëm kur kjo është e nevojshme, duke e trajnuar personelin në lidhje me çfarë duhet dhe nuk duhet të bëjë. Aksesin në ambientet e punës ku përpunohet të dhëna personale të lejohet vetëm atyre individëve që janë të autorizuar. Pajisjet për përpunimin e të dhënave të përdoren vetëm ashtu siç janë autorizuar dhe që gjithë këto pajisje të kenë aparate që parandalojnë përdorimin e paautorizuar. Të vendosen rregulla ku të përcaktohet që modifikimi, korrigjimi, fshirja dhe transferimi i të dhënave personale dhe veprime të tjera në lidhje me të dhënat personale të regjistrohen dhe të dokumentohen.

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale, ku të përfshihen edhe rregulla për përdorimin e sistemit të “video survejimit” (CCTV). (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
2. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të kryhet brënda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dëjani të këtij Rekomandimi.
3. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit... “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues,veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij,vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

